



Duke u mbështetur në nenin 40 paragrafi 2 nën b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Qarkoren buxhetore 2020/1 dhe 2020/2 si dhe nenin 40 paragrafi 2 nën pikën 2 të Statutit të Komunës së Klinës, rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 18.09.2019 dhe debatin me publikun më 16.09.2019, Kuvendi i Komunës së Klinës, në seancën e VIII- të për vitin 2019 të mbajtur më 27.09.2019 mori këtë:

V E N D I M

Për

Aprovimin e propozim - buxhetit komunal për vitin 2020-2022 përfshirë projektet kapitale

I

Miratohet buxheti i Komunës së Klinës dhe Projektet me prioritet për vitin 2020.

II

Buxheti i Komunës së Klinës për vitin 2020 është në shumën totale prej 11,054,140.00 €.

Kategorit buxhetore	Planifikimi 2020	Vlersimi 2020	Vlersimi 2022
1. Paga dhe medijtje	6,890,357.00	7,267,201.00	7,580,250.00
2. Mallra dhe sherbime	1,120,934.00	1,120,934	1,120,934.00
3. Komunalit	180,000.00	180,000.00	180,000.00
4. Transfere dhe subven	200,000.00	200,000.00	200,000.00
5. Kapitale	2,662,849.00	2,645,298.00	2,725,743.00
Totali	11,054,140.00	11,413,433.00	11,806,927.00

III

Buxheti si në pikën II të këtij Vendimi dhe lista e projekteve kapitale me prioritet për vitin 2020, miratohen me vërejtje dhe ndryshime që janë pjesë e procesverbalit të Kuvendit.

IV

Kompetent për ekzekutimin e këtij Vendimi është Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.

V

Vendimi është i plotfuqishëm më miratimin nga Kuvendi i Komunës së Klinës dhe 15 ditë pas protokollimit në MAPL .

Me këtë vendim njoftohen : MAPL, MF, Kryetari i Komunës, Drejtoria e FEZH, Zyra për Informim, Shërbimi për punë të Kuvendit, një kopje për Arkivin e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-41252- 2019
Klinë, më 30.09.2019

